

Në pajtim me dispozitat e nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-149 për shërbimin civil të Republikës së Kosovës, Rregullores nr. 06/2010 për procedurat e emërimit në pozita të larta drejtuese në shërbimin civil të Republikës së Kosovës dhe nenit 40, 41 dhe 42 të Statutit të Përkohshëm, Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, shpall

## K O N K U R S

Titulli i vendit të punës: **Sekretar i Përgjithshëm i Universitetit**

Kandidatët që konkurojnë për këtë vend pune, përveç kushteve të përgjithshme të parapara me Ligjin për Shërbyesit Civil të Republikës së Kosovës, nr.03/L-149, duhet t'i plotësojnë edhe këto kushte:

- Të kenë përgatitje universitare Master ose ekuivalent më së paku katër (4) vjet të studimeve, duhet të jenë nga fusha profesionale e drejtësisë, të ketë pesë (5) vjet përvojë pune profesionale, të ketë aftësi të dëshmuar organizative dhe menaxhuese, të ketë njohuri të mjaftueshme për proceset e arsimit, kërkimeve dhe artit.

### **Detyrat - Përgjegjësitë:**

- Është zyrtari më i lartë i administratës;
- Është udhëheqës i Administratës Qendrore;
- Është shef i zyrarëve për çështje juridike në fakultete;
- Është zyrtar përgjegjës për udhëheqjen efikase, ekonomike dhe efektive të Universitetit;
- Është shef i drejtorëve të departamenteve në kuadër të Administratës Qendrore;
- Është zyrtar përgjegjës për përgatitjen teknike të procesit buxhetor;
- Është përgjegjës për çështje të tjera që kërkohen nga Rektori dhe Këshillit Drejtues, të cilat nuk janë të përcaktuara me Statut.

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e shpalljes në gazetë, përkatësisht nga data 11/10/2018 e deri më 25/10/2018 në ora 16.00.

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, nëse arrijnë brenda 4 ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.

Inkurajohen të aplikojnë pjesëtarët e minoriteteve.

Paraqitja e dokumentave bëhet në Rektoratin e Universitetit të Shkencave të Aplikuara Ferizaj, Rr."Universiteti"p.nr. Ferizaj, zyra nr. 009.

### **Dokumentacioni duhet të përmbajë:**

- Aplikacionin,
- Një letër motivuese,
- CV-në,
- Kopjen e diplomës të noterizuar,
- Dokument identifikimi (Originali ose kopja e letërnjoftimit apo certifikatës së lindjes e noterizuar),

- Dëshminë që personi nuk është nën hetime,
- Dokumentat tjera relevante për pozitën që aplikoni (dëshmitë e përvojës së punës profesionale, etj).

Ditën e intervistimit, kandidatët duhet të sjellin me veti dokumentacionin në origjinal.

Konkursin mund ta gjeni edhe ne faqen e internetit në këtë adresë <http://www.ushaf.net>. Në procedurën për menaxhimin e pozitave të larta drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përshtatshëmrisht zbatohen dispozitat e përgjithshme për nëpunësit civil të përcaktuara me Ligjin për shërbimin civil dhe aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji.